

**Si mund ta ndihmoj fëmijen tim për të lexuar dhe kuptuar më mirë?
Prof. Dr. Claudio Nodari, Instituti për komunikim interkulturore, Cyrih**

1. Mësimi i gjuhës është një proces mjaft kompleks. Çdo fëmijë e mëson gjuhën e familjes ku edhe rritet, apo gjuhën e rrethit ku edhe jeton, por shpesh jo mjaft mirë, për te qenë edhe i suksesshëm në shkollë.
2. Ato fëmijë, te cilët në përditshmëri kultivojnë dhe përjetojnë një kontakt intenziv me gjuhën e rrethit, zakonisht kanë më pak probleme.
3. Personat e afërm të fëmijës (kjo do të thotë prindërit, por edhe vëllezerit dhe motrat, te afërmit familjarë dhe personat kujdestarë p.sh. në çerdhe apo në kopsht etj.) kanë ndikim mjaft të madh në kultivimin dhe ngritjen e kompetencës gjuhësore të fëmijës; kjo e sidomos, kur ato flasin mjaftueshëm me fëmijën në gjuhën e tyre.

Çka mund te bëjnë personat referues për fëmijën, në kohën jashtë shkollës, për ta ndihmuar atë në të kuptuarit e asaj që lexohet?

0 deri 2 vjet – fëmijë i moshës së vogël

1. Personat referues flasin shpesh me foshnjën. Ata përshkruajnë atë se ç'ka bëjnë, se ç'ka aty, kush është aty, apo se ç'bën foshnja etj.
2. Personat referues flasin secili gjuhën e tyre. Parimi themelor është: «Një person — një gjuhë».
3. Ata shmangin sa me shume që është e mundur përzierjen e gjuhëve të ndryshme.

2 deri 4 vjet – mosha parashkollore

1. Personat referues ndjekin parimin «Një person - një gjuhë».
2. Ata flasin shpesh me fëmijen mbi përditshmërinë (si është e si duket bota? Çka ka ndodhur? Çka bëjmë ne?)
3. Pyetjeve të fëmijëve, ata ju përgjigjen me sqarim të duhur dhe durim.
4. Ata tregojnë përralla nga librat e ilustruar.
5. Ata i përshkruajnë figurat nga librat e ilustruar
6. Ata i komentojnë vizatimet e fëmijës.

7. Personat referues, mundësojnë kontakte me fëmijët e tjerë, (edhe atë në kopshtin e fëmijëve, në grupin e lojërave të fëmijëve, në çerdhe etj.) dhe mundësojnë e lejojnë që fëmija të luan me fëmijët e tjerë.

4 deri 7 vjet - kopshti i fëmijëve

1. Personat referues flasin ende sipas parimit «Një person - një gjuhë». Shmangie nga ky parim janë të mundëshme, nëse është i pranishëm dikush, i cili/e cila nuk e kupton gjuhën që flitet.
2. Ata iu sqarojnë fëmijeve se kush është, apo si flet dikush dhe pse.
3. Personat referues flasin shpesh me fëmijen mbi përditshmerinë (se çka ka ndodhur? Apo si funksionon kjo? Pse është kjo keshtu? Kush është kush? Apo kush bën çka ?)
4. Ata iu rrëfejnë fëmijeve të tyre, përjetime nga fëmijëria e tyre, mbi të afërmit e familjes etj.
5. Ata iu tregojnë fëmijëve tregime nga libra të ilustruar, stripa etj.
6. Ata iu lexojnë me zë fëmijëve, tregime e kallzime nga libra të ilustruar.
7. Fëmijet i shikojnë disa herë videofilmat (p.sh. filmat e Walt Disney-it). Personat referues i lexojnë librat e Walt Disney-it disa herë me zë ose i rrëfejnë ngjarjet në lidhje me fotografitë apo ilustrimet në libër.
8. Fëmijet i dëgjojnë disa herë tregimet prej shiritave apo inçizimet (p.sh. nga audiokasetat ose audio-CD-të), mundësisht së bashku me librat perkatës (vëreni librin e vizatuar Multidingsda).

7 deri 9 vjet – mosha e ciklit të ulët shkollor

1. Përzgjedhja e gjuhës varet nga rasti (do me thënë nga personat e pranishëm ose nga temat e përzgjedhura). Personat referues janë të vetëdijshëm se kultivimi i gjuhës së parë/amtare varet nga anetarët e rritur të familjes.
2. Personat referues flasin shpesh me fëmijen mbi përditshmërinë (shkollën, punën, ushqimin, planet për fundjavë, sportin etj.)

3. Ata tregojnë tregime nga libra të ilustruar.
4. Ata lexojnë me zë, pjesë nga libra të ilustruar, apo stripa (tek librat gjermanisht, pjesa e fundit t'i lihet fëmijes për lexim)
5. Fëmijet i shikojne disa here videofilmata (p.sh. filmat e Walt Disney-it). Personat referues i lexojnë librat e Walt Disney-it me zë (tek librat gjermanisht, pjesa e fundit t'i lihet vetë fëmijes për lexim)
6. Fëmijet i dëgjojnë tregimet nga audiokasetat ose audio-CD-te bashkë me librat perkatës.
7. Fëmijet marrin nga biblioteka materiale për të lexuar. Kur shkojnë atje, mundësisht personat referues i percjellin ata me këtë rast.
8. Personat referues lexojnë me fëmijet libra tematikë me tema që iu interesojnë fëmijeve (por edhe kryejnë eksperimente të ndryshme, të cilat përshkruhen në librat tematikë; përgatisin shujta ushqimore të përshkruara në librat e recetave)

10 deri 12 vjet – mosha e ciklit të mesëm shkollor

1. Personat referues flasin shpesh me fëmijen mbi përditshmerinë (shkollën, punën, lidhjet shoqërore apo faqefisnore, sjelljet, aktualitetin, rëndesine e të lexuarit etj.)
2. Personat referues dakordojnë me fëmijen një kohë leximi (çdo dite nga 20 minuta lexim, ose çdo të shtune dhe të diele nga ora 17⁰⁰ deri në orën 17⁵⁰).
3. Fëmija ka të drejtë t'i kerkojë vetë librat që dëshiron t'i lexojë (edhe stripat) dhe personat referues kujdesen për t'i siguruar ato (biblioteka, www.amazon.com, librari).
4. Personat referues abonojnë sipas dëshires së fëmijës ose për një kohë të shkurtër sa për provë ndonjë revistë, dhe me atë rast duhet që fëmijet të obligohen për ta lexuar atë.
5. Personat referues kujdesen për të instaluar një kompjuter në shtëpi dhe fëmija fillon të njohë e mësojë kompjuterin, përmes lojërave kompjuterike.